



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

05.Nr. 279/17
Datë: 03.08.2017

Në bazë të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, neni 8 ,paragrafi 1 dhe 2, Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, neni 31, paragrafi 1 dhe 2 , Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, neni 5 pika c , dhe në mbështetje të: UA-MPMS, nr.14/2011 (Rregullimi i procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik), UA - MASHT, nr.05/2015 (Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional), UA-MASHT, nr.06/2015 (Normativi për kuadrin profesional në arsimin e përgjithshëm), UA-MASHT, nr.10/2015 (Për kontratën e punës së mësimdhënësve të arsimit parauniversitar) dhe Vendimeve të MASHT-it ,Kabineti i Ministrit ,sipas Referencave:230/01B, 231/01B ,232/01B dt.04.08.2015, Drejtoria Komunale e Arsimit , shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës, viti shkollor 2017/2018

Shfmu "Bajram Curri" Istog

1. Një mësimdhënës për nivelin 1-5, zëvendësim deri sa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis.
2. Një mësimdhënës/e të edukatës muzikore me normë jo të plotë 10 orë

IP "Gzimi Ynë" Istog

1. Një edukatore për grup moshat 4-5 vënd i lirë.

Shfmu "Hysni Zajmi" Vrellë

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, paralelja e ndarë Prigodë, vënd i lirë.
2. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, paralelja e ndarë Prigodë, zëvendësim derisa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.
3. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze, zëvendësim derisa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis (Prigodë-Studenicë)

Shfmu "Trepça" Banjë

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5 vënd i lirë i punës prej datës 15.09.2017.

Shfmu "Fan S.Noli" Llukac i Begut

1. Një mësimdhënës të nivelit 1-5 (në gjuhën shqipe)
2. Një mësimdhënës i lëndës së kimisë (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë-12 orë në Dobrushë dhe Banjë.
3. Një mësimdhënës i lëndës së fizikës (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë-16 orë në Dobrushë dhe Banjë.
4. Një mësimdhënës i lëndës së biologjisë (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë-16 orë në Dobrushë dhe Banjë.

Shfmu "Ndre Mjeda" Rakosh

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5 ,zëvendësim derisa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis.
2. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze për 20 orë zëvendësim derisa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis në Rakosh, Kërrninë dhe Veriq.
3. Një mësimdhënës të kulturës muzikore me normë jo të plotë në Rakosh, Shushicë dhe Uçë, 16 orë.

Shfmu "Ismail Qemali" Saradran

1. Një edukatore për parafillor në paralelen e ndarë në Trubuhoc, 18 orë.
2. Një mësimdhënës të kulturës muzikore me normë jo të plotë në Saradran dhe Zallq me 15 orë

Shfmu "Avni Rrustemi" Zallq

1. Një mësimdhënës për nivelin 1-5, klasë të kombinuara, paralelja në Kosh vendi i lirë i punës nga data 24.10.2017

Shfmu " Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe " në Uçë

1. Dy mësimdhënës për nivelin 1-5 klasë të kombinuara, një në Cerkoz dhe një në Padalishtë

Shfmu "Mehmet Akifi" Shushicë

1. Një mësimdhënës për nivelin 1-5, Shushicë e Ulët

Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Frënge normë e plotë vend i lirë
2. Një mësimdhënës/e për Biologji zëvendësim derisa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.
3. Një mësimdhënës/e për Histori vendi i lirë i punës nga data 19.09.2017 për 18 orë

Shmt " Mithat Frashëri " Gurrakoc

1. Një mësimdhënës për lëndën gjuhë angleze, paralelja "Rudina" Burgu i Dubravës,
2. Një mësimdhënës për lëndën e Fizikës me normë të plotë, 14 orë në M. Frashëri në Gurrakoc dhe 7 orë në Rudina.

Norma e punës për mësimdhënësit në SHMT dhe paralelen e ndarë "Rudina" B.i Dubravës është vetëm planifikim. Norma do të jetë e sakt vetëm kur lidhet kontrata sepse nuk dihet formimi i grupeve të kandidatëve në këtë qendër korrektuese.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit(kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes
- Diplomat e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës por jo më e vjetër se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk shqyrtohet,
- Kandidatet të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nese ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nese ka)

Dokumentacioni i kompletuar në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit, dorëzohet në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra nr.100, kati përdhësë.

Dokumentacioni duhet të jetë kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shëben deri në përfundim të procedurës së konkursit. Nuk kthehet as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet. Kandidati i cili nuk e plotëson qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

Për intervistë do të ftohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin e lartë cekur.

Kushtet e konkursit: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të rezultateve të intervistës dhe kriterëve që përcaktohen me udhëzimet administrative të MASHT-it : UA/nr.05/2015, UA/nr.06/2015, UA/ nr.10/2015 dhe Vendimet e MASHT, sipas referencave të cekura në fillim të konkursit.

Gjatë përzgjedhjes, në kushte të barabarta, përparësi do të kenë mësimdhënësit që janë në shtet që ligjerisht u mundësohet levizja horizontale ose ata që pa fajin e tyre kanë mbetur pa vend pune në ndonjërin nga shkollat e komunës së Istogut duke patur gjithmonë parasysh kriterin e përgatitjes profesionale.

Me respekt !

Drejtori i DKA-së

